

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
AGJENCIONI KOSOVAR PËR PRONA, KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU, ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-044/15

Prishtinë,
27 korrik 2017

Në çështjen juridike të:

T. P.

Pala ankuese

kundër

**SOS “K. I.”
Përfaqësuar nga
N. R.S.**

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Anna Bednarek dhe Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA10621), të datës 13 mars 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 27 korrik 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga T. P. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, të datës 13 mars 2014, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA10621, refuzohet si e pabazuar.

2. **Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, i datës 13 mars 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar me numrin KPA10261, vërtetohet.**

Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale :

1. Më 23 nëntor 2006, T.P. (tani e tutje: “pala ankuese”) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP), me anë të së cilës ka kërkuar ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. 2554/5, e cila gjendet në Velani, Prishtinë, ku pa lejen e tij dhe pa asnjë kompensim është ndërtuar një shtëpi për jetimët e luftës. Më vonë, pala ankuese ka sqaruar se ai kërkon kompensimin e dëmit si kundërvlerë për pronën e eksproprijuar nga Komuna e Prishtinës në vitin 2000.
2. Së bashku me kërkesën, pala ankuese *inter alia*, ka dorëzuar dokumentet në vijim:
 - Fletën poseduese nr. 10043, të lëshuar më 8 qershor 1975 nga Drejtoria për Gjeodezi në Prishtinë, në të cilën prona e kërkuar figuron e regjistruar në emër të palës ankuese.
 - Kopjen e planit të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi në Prishtinë më 30 qershor 1995.
 - Procesverbalin nga seanca e Kuvendit Komunal të Prishtinës e datës 1 korrik 1994 i cili përmban Marrëveshjen për Kompensim, në bazë të së cilës pala ankuese e ka fituar pronën nga V.S.
 - Përshkrimin e fletës poseduese nr. 10043, të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi në Prishtinë, e zhvendosur në Republikën e Serbisë, më 10 prill 2003, në të cilën emri i palës ankuese figuron si pronar i pronës së kërkuar.
3. Më 15 dhjetor 2010, AKP-ja e ka bërë njoftimin e kërkesës, e ka vizituar pronën. Prona e kërkuar është gjetur të jetë e zënë nga pala përgjegjëse në ankesë dhe së bashku me disa ngastra tjera është transferuar tek kopshti për fëmijë.
4. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ia ka dorëzuar kërkesën N. R. S., në emër të SOS “K. I.” (tani e tutje: “pala përgjegjëse në ankesë”). Ajo ka paraqitur përgjigje ndaj kërkesës dhe ka pohuar se pala tjetër po e kërkon të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar të fituar në bazë të eksproprijimit dhe ndarjes së tokës ndërtimore, lejes së ndërtimit të lëshuar nga autoritetet dhe ndërtimin e kopshtit për fëmijë. Për t’i mbështetur pretendimet e saj, pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar dokumentet në vijim:
 - Marrëveshjen në mes të Shoqatës Austriake SOS-K. I. me Qeverinë e Kosovës, për ndërtimin e kopshteve për fëmijë, të lidhur më 22 tetor 2004.
 - Vendimi mbi dhënien e lejes urbanistike 05 Nr.350-178 të lëshuar nga Administrata e UNMIK-ut më 01.02.2001.
 - Lejen e ndërtimit të lëshuar nga Administrata Ndërkombëtare e UNMIK-ut më 14 shkurt 2001, me të cilën palës përgjegjëse në ankesë i lejohet ndërtimi i kopshtit për fëmijë në pronën e kërkuar.

- Vendimi mbi ndryshimin e planit urban në lagjen “Velanija”, në të cilën gjendet prona e kërkuar.
 - Vendimi i UNMIK-ut për ndarjen e tokës ndërtimore palës përgjegjëse në ankesë.
 - Certifikata e regjistrimit të OJQ-së e lëshuar nga, Zyra e UNMIK-ut për Regjistrimin e Bizneseve në Prishtinë, më 5 janar 2000.
5. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të datës 11 korrik 2011, dokumentet e dorëzuara nga pala ankuese nuk janë gjetur as në komunën e Prishtinës e as në kadastrin e zhvendosur. Dokumentet e dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë janë gjetur dhe janë verifikuar pozitivisht.
 6. Më 13 mars 2014, KKPK me vendimin e saj KPCC/D/A/228/2014 (tani e tutje: “Vendimi i KKPK-së”, “Vendimi”) ka hedhur poshtë kërkesën për faktin se pala ankuese ka kërkuar kompensim të dëmit. Në arsyetimin përkatës, në paragrafin 48, është theksuar se komisioni ka konsideruar se nuk ka kompetenca për kërkesat për kompensim për shfrytëzimin e pronës pa pëlqim ose për dëmin e shkaktuar.
 7. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 18 gusht 2014. T. P. ka paraqitur ankesë më 10 shtator 2014. Pala përgjegjëse në ankesë e ka pranuar ankesën më 10 shkurt 2015, dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigjen më 4 mars 2015.

Pretendimet e palës ankuese

8. Pala ankuese thekson se vendimi i Komisionit përmban zbatim të gabuar të ligjit material dhe të procedurës dhe mbështetet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ai pretendon se objekti i kërkesës së tij ka qenë lirimi i tokës së tij për të cilën ka dorëzuar prova të mjaftueshme se ka qenë pronë e tij.
9. Pala ankuese e kundërshton konstatimin e Komisionit për faktin se eksproprijimi i pronës së tij nuk është bërë në përputhje me ligjin dhe se ai asnjëherë nuk është kompensuar për humbjen e saj.
10. Në fund, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që t’ia vërtetojë pronësinë mbi pronën e kërkuar, ta urdhërojë Zyrën e kadastrit që t’ia regjistrojë pronësinë në regjistrin kadastral dhe ta urdhërojë Komunën e Prishtinës që t’ia lirojë pronën e tij ose ta kompensojë të njëjtën me një tokë tjetër me vlerë dhe distancë të njëjtë nga qendra e qytetit sikurse prona e kërkuar.

Pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë

11. Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se ajo i është nënshtruar të gjitha procedurave ligjore për marrjen e lejes së punës dhe lejes për ndërtimin e kopshtit të fëmijëve. Përveç kësaj, ajo thekson se prona ishte ekspropriuar gjithashtu edhe në vitin 1980 nga Komuna e Prishtinës dhe se pala ankuese nuk kishte ndonjë dëshmi mbi pronësinë e pretenduar, prandaj kërkesa e tij duhet të refuzohet. Në cilindo rast eventual ose në kontest gjyqësor, pala përgjegjëse në ankesë konsideron se ajo e ka fituar pronësinë në mirëbesim dhe se nuk ishte në dijeni se kjo pronë mund të kishte një pronar individual të pa kompensuar për eksproprijim.

Arsyetimi ligjor

12. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të pretendimeve të ankesës dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës, përfundon se vendimi i KKPK-së nuk përmban asnjë gabim esencial apo zbatim të gabuar të ligjit material në fuqi, e as nuk bazohet në vërtetim të gabuar apo jo të plotë të fakteve. Prandaj, ankesa nuk mund të aprovohet, sidoqoftë me arsyetim të ndryshëm nga arsyetimi i paraqitur në vendim.
13. Sipas nenit 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-079, KKPK-ja është kompetente për zgjidhjen e kërkesave pronësore të lidhura me konfliktin dhe kërkesat për të drejtat pronësore "që lidhen drejtpërsëdrejti me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. "Kjo do të thotë se fushëveprimi i shqyrtimit të AKP-së është verifikimi i elementeve në vijim: kush ishte në posedim të pronës së kërkuar para 27 shkurtit 1998, kush e ka në posedim tani, kur dhe për çfarë arsye është humbur posedimi gjatë periudhës midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Nëse Komisioni verifikon se posedimi i pronës së kërkuar është humbur para ose pas datave të cekura më lart ose që humbja e posedimit nuk ka qenë e lidhur me konfliktin, ai e hedhë poshtë kërkesën në bazë të nenit 11.4 (b) të Ligjit Nr. 03/L-079.
14. Siç shihet nga shkresat e lëndës, pala ankuese nuk ka provuar se ai nuk ka qenë në posedim të pronës së kërkuar gjatë periudhës në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 dhe për këtë arsye Gjykata Supreme nuk mund të nxjerrë konkluzion se pala ankuese e ka humbur posedimi e pronës për shkak të konfliktit. Në fakt, dokumentet e paraqitura nga pala ankuese, të cilat - sipas tij - e provojnë të drejtën e tij pronësore mbi pronën e kërkuar, ishin kopjet e Marrëveshjes, fleta poseduese dhe kopja e planit. Sidoqoftë, Gjykata Supreme dëshiron të theksojë se ligji në fuqi në vitin 1994, kur është nënshkruar marrëveshja nuk parashihte mundësinë e fitimit të të drejtave pronësore ndaj pronës së paluajtshme në bazë të marrëveshjes së nënshkruar nga palët e tjera, përfshirë kuvendin komunal. Për më tepër, dokumentet si fleta poseduese dhe kopja e planit që kanë për qëllim vërtetimin e titullarit të pronës së kërkuar duhet të verifikohen në të gjitha rastet pranë autoriteteve kompetente. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme për t'i verifikuar dokumentet e përmendura në Kosovë dhe Krushevc, por askund nuk kanë mund të verifikohet pozitivisht. Për këtë arsye, palës ankuese i është kërkuar që të paraqes dokumente të tjera që i ka posedim, me qëllim të vërtetimit të pronësisë së tij dhe posedimit të pronës së kërkuar para ose gjatë konfliktit.
15. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme gjen se vendimi i KKPK-së është i drejtë dhe mbështetet në ligjin në fuqi. Prandaj, ankesa është e pabazuar dhe duhet të refuzohet.

16. Për më tepër, pasi që KKPK-ja nuk ka kompetenca mbi kërkesat për kompensim, kërkesa e palës ankuese në lidhje me këtë është hedhur poshtë si e papranueshme në përputhje me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03 / L- 079.
17. Ky aktgjykim nuk e cenon të drejtën e palës ankuese që t'i kërkojë të drejtat e tij para gjykatës kompetente, nëse e konsideron të nevojshme.
18. Nga ajo që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 nën-paragrafi (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L- 079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, kryetar i kolegjit

Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it

Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtar

Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it